

Lenda PML 125/2014
8 korrik 2014

MENDIM I NDARË PJESËRISHT MOSPAJTUES I GJYQTARIT TIMO VUOJOLAHTI

Unë nuk pajtohem me shumicën në lidhje me çështjen e pranueshmërisë së kërkesave të paraqitura nga dy avokatët mbrojtës të të pandehurit, avokatit EJ [redacted] dhe avokatit [redacted] MB

Çështja

Çështja e adresuar në mendimin tim të ndarë mospajtues është: A lejon kodi aktual i procedurës (Kodi i Procedurës Penale - KPP), kur të pandehurin e përfaqësojnë më shumë se një avokat mbrojtës, që secili avokat mbrojtës të ketë autorizim të ndarë dhe individual që ta përfaqësojnë klientin e tyre në të njëjtën kohë?

Faktet

Nga shkresat e lëndës mund të konstatohet se i pandehuri EK [redacted] është përfaqësuar nga tre avokat mbrojtës, avokatët [redacted] EJ, MB, SS [redacted]. Që të tre kanë paraqitur ankesa të ndara në emër të klientit të tyre të përbashkët kundër aktgjyqimit të shkallës së parë (Gjykatës së Qarkut të datës 11.05.2012), dhe Gjykata e Apelit (aktgjyqimi i kundërshtuar i datës 25.9.2013) ka konsideruar të gjitha ankesat si të pranueshme.

Tani, dy nga avokatët mbrojtës, avokatët J dhe B [redacted], më 8 maj 2014 (brenda afatit kohor) kanë paraqitur kërkesa të ndara për mbrojtje të ligjshmërisë në emër të klientit të tyre. Për më tepër, i pandehuri K [redacted] ka bashkangjitur kërkesën e tij në kërkesën e paraqitur nga avokatit B [redacted].

Ligji

Neni 55 paragrafët 2 dhe 3 të KPP-së përcaktojnë:

2. I pandehuri mund të ketë detyrë në tre mbrojtës. Është e drejta për mbrojtje konsiderohet se është e mjaftueshme kur në procedurë merr pjesë njëri nga mbrojtësit.

3. Nëse i pandehuri ka më shumë se një mbrojtës, njëri nga ta caktohet si mbrojtës kryesor nga i pandehuri, e në rast se i pandehuri nuk bën një gjë të tillë, gjyqtari kompetent cakton mbrojtësin kryesor.

Neni 61 i KPP-së përcakton se avokati mbrojtës ka të njëjtat të drejta sikurse edhe i pandehuri të njohura me ligj, përveç atyre të rezervuara në mënyrë eksplicite për të pandehurin personalisht.

Neni 19, paragrafi 1, nën-paragrafi 28 përcakton:

Mbrojtësi kryesor - kur një palë përfaqësohet nga më shumë se një mbrojtës, një dhe vetëm një mbrojtës përfaqëson palën para gjykatës ose gjatë procedurave penale. Kur mbrojtësit kryesor i dorëzohen dokumentet, përfshirë aktakuzat, kërkesat, përgjigjet, ankesat dhe dokumentet tjera të cilat duhet t'i zbulohen të pandehurit, konsiderohet se dorezimi u është bërë të gjithë mbrojtësve që përfaqësojnë palën.

Vlerësimi im

Para se të filloj me vlerësimin ligjor më duhet të theksoj se, në këtë lëndë kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktgjyimit të formës së prerë të Gjykatës së Apelit nuk është rast i mbrojtjes së detyruar (neni 57.(1.4)). Përkatësisht, një situatë e tillë mund të caktoj disa kushte të tjera për shfrytëzimin e disa avokatëve mbrojtës.

Vlerësimi i ligjit

Unë konsideroj se është shumë e qartë se ideja themelore e cila qëndron pas mundësisë së të pandehurit që të angazhoj më shumë se një avokat për ta mbrojtur atë është për të siguruar mbrojtje të mjaftueshme dhe efektive. E drejta në mbrojtje efektive nga avokati është njëra nga elementet fundamentale të gjyqimit të drejtë. Nevoja për të pasur më shumë se një avokat mund të paraqitet kur lënda është shumë e gjerë, ose kur përmban çështje ligjore jashtëzakonisht të vështira, ose kur mbrojtja duhet të bëjë shumë hulumtime etj. në këto situata mund të nevojitet kontributi i më shumë se një avokati për të pasur mbrojtje të duhur. Dhe pastaj, një ndarje e qartë e punës është faktori i cili mundëson një mbrojtje efektive.

E drejta për mbrojtje efektive është e drejtë e garantuar e të pandehurit. Edhe pse avokati i cili përfaqëson të pandehurin ka të drejtat e njëjta sikurse edhe i pandehuri të njohura me ligj (neni 61 i KPP-së), këto të drejta nuk mund të

konsiderohen si të drejtat e tij personale ose individuale, të ndara nga të drejtat e të pandehurit. Kjo do të thotë se avokati mbrojtës përfaqëson të pandehurin vetëm në interes të klientit të tij – të gjitha të drejtat e tij burojnë nga të drejtat e të pandehurit.

Kur i pandehuri ka më shumë se një avokat mbrojtës është e qartë se të gjithë avokatët kanë përgjegjësi të përbashkët për ta mbrojtur të akuzuarin në mënyrë efektive. Sidoqoftë, dispozita e nenit 55.3 të KPP-së tregon se duhet patjetër të ketë koordinim dhe pajtueshmëri në punën e avokatëve dhe njëri prej tyre duhet ta ketë përgjegjësinë për këtë aranzhim. Pa arsytim të mëtutjeshëm, të gjithë e kuptojnë se do të ishte në kundërshtim me të drejtat e të pandehurit nëse avokatët në ankesat dhe kërkesat e tyre me shkrim arsye dhe argumente tërësisht jo-relevante dhe kontradiktore. Për më tepër, përsëritja e arsyeve dhe argumenteve të njëjta është shenjë e jo efektivitetit dhe vetëm tregon se nuk ka pasur nevojë faktike për të pasur më shumë se një avokat mbrojtës në atë fazë të procedurës.

Neni 19.(1.28) i KPK-së pohon qartë¹, se kur një palë përfaqësohet nga më shumë se një mbrojtës, një dhe vetëm një mbrojtës [theksim i imi] përfaqëson palën para gjykatës ose gjatë procedurave penale. Kur mbrojtësit kryesor i dorëzohen dokumentet, përfshirë aktakuzat². Interpretimi i fjalëpërfjalshëm i kësaj rregulle tregon se në procedurë të shkruar, si paraqitja e kërkesës për mjet të jashtëzakonshëm juridik, vetëm një avokat duhet të përfaqësojë të pandehurin – prandaj, në emër të të pandehurit paraqitet vetëm një kërkesë. Po i referohem formulimit të nënvizuar më lart, i cili tregon se ligjvënësi ke vënë theksin në fjalën 'një' duke e përsëritur atë, që edhe mua më tregon se qëllimi i ligjvënësit nuk është t'u japë të drejta të veçanta individëve ose secilit avokat për të paraqitur ankesa apo kërkesa. Ky interpretim merr parasysh edhe efektivitetin e mbrojtjes dhe shërben për të synuar një procedurë të qartë dhe koherente qartësuar. Nuk do të thotë se nëse i pandehuri dëshiron t'i ketë disa avokatë mbrojtës edhe për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshme, ai/ajo nuk mund t'i shfrytëzojë ata. Në atë situatë avokatët vendosin se si i zbatojnë kushtet e përcaktuara me ligj. Nëse duhet të bëhet ndarja e punës për shkak të volumit të lëndës, të shtrirjes së kërkesës, ose për shkak të vështirësive së lëndës dhe

¹ Dispozita përshfaqet si rregull e dukshme dhe të qartë, edhe pse qo rregull është i referuar në mënyrë deklarative. Megjithatë, dita e perdite po bëhet me a qarte se ligji i tanishem nuk mund të konsiderohet i qartë, koherent dhe si tematik; prandaj një rregull e qarte nuk mund të injorohet vetëm ose paraqitet në vend të qartuar.

² Duhet të theksohet se ligji i mëshëm, Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, në formën që fillon më 12.12.2013, nuk bazohej asnjë dispozite me këtë kuptim të njëjtë.

nëse avokatët vendosin vetë të punojnë kështu, atëherë puna e secilit dhe rezultatet e tyre duhet të përmbledhen bashkë në një kërkesë. Në fund, përgjegjësia për këtë i takon mbrojtësit kryesor.

Vlerësimi i lëndës

Kërkesat e dy mbrojtësve janë paraqitur ndaras, dhe nuk ka indikacione se avokatët mbrojtës kanë pasur qëllim që kërkesa të jetë e vetme. Prandaj, interpretimi i lartpërmendur i dispozitave përkatëse më bën të arrij në përfundim se në gjykimin e kësaj lënde vetëm njëra kërkesë duhet të shqyrtohet.

Në lëndën konkrete, gjatë vendosjes se cila kërkesë është e pranueshme nuk kemi asnjë faktor tjetër për të zbatuar përveç faktorit 'mbrojtësi kryesor'. Në shkresat e lëndës nuk kam gjetur asnjë të dhënë specifike se cili prej tyre është mbrojtësi kryesor. Megjithatë, duke u bazuar në faktin se mbrojtësi [redacted] e ka përfaqësuar të pandehurin në fazat e mëhershme të gjyimit, konsideroj se ai është mbrojtësi kryesor. Prandaj, konstatoj se kërkesa e paraqitur nga mbrojtësi [redacted] duhet të konsiderohet si e pranueshme kurse kërkesa e paraqitur nga mbrojtësi [redacted] të konsiderohet si e papranueshme.

Para se të arrija në këtë përfundim më është dashur të vlerësoj se a është cenim i të drejtës së të pandehurit nëse kërkesa e avokatit mbrojtës [redacted] hedhet poshtë. Siç është theksuar në arsyetimin e këtij vendimi, kërkesa e paraqitur nga avokati mbrojtës [redacted] është shpallur e pabazuar. Po të kishte ndonjë bazë ligjore apo argument valid që do të qonte deri te pranimi i kërkesës, do të isha i detyruar të kërkoja vëmendjen e mbrojtësit kryesor lidhur me këtë çështje dhe t'i ofroja atij mundësinë që ta bëjë plotësimin e kërkesës së tij.

Duke u bazuar në keto arsye konstatoj se kërkesa e paraqitur nga avokati mbrojtës [redacted] është e papranueshme. Sa i përket kërkesave të paraqitura nga vetë i pandehuri dhe nga avokati mbrojtës [redacted] pajtohem me shumicën

OBITER DICTUM I Gjyqtarit VUOJOLAHTI:

Përveç arsyetimit tim të sipërpermendur kam edhe një vërejtje që dua ta shpreh në lidhje me këtë çështje:

Në rastet kur të pandehurin e përfaqësojnë me shumë se një avokat mbrojtës, është bërë një zakon i përvend në Kosovë që avokatët secili t'i paraqesin veçmas

kerkesat për mbrojtje të ligjshme kundër vendimit të njëjta në emër të klientit të përhasket. Përvoja ime në këto situata më thotë se nuk është e pazakonte që disa kërkesa për mbrojtje të ligjshme kryesisht i përsërisin bazat dhe argumentet e njëjta, dhe bazat dhe argumentet e paraqitura janë shumë shpesh dukshëm të pajustificuara. Qëllimi i ligjvënësit – për të siguruar mbrojtje të efektshme për të pandehurin duke lejuar më shumë se një avokat mbrojtës – qenka harruar. Në vend të kësaj, shumë shpesh kemi kërkesa jo koherente dhe ngatëruese, që e pengojnë gjykatën për t'u përqendruar në çështje të rëndësishme.

Me qëllim të përmirësimit të efikasitetit të mbrojtjes është koha që t'u kushtojmë vëmendje dispozitave të sipërpërmendura.

Fimo Vuojolahti
Gjyqtar i EULEX-it